



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:010461

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747256

KPPP.nr.64/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Profiti” N.T.SH., me NUI:810466658, me seli në Prishtinë, Ish Fabrika e Amortizatorëve, kundër debitorit “B.F.Z.” B.I., me NUI:811101857, me seli në Viti, fshati Pozhoran, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.352/23 të datës 12.12.2023, të Përmbartuesit Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “B.F.Z.” B.I., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.352/23 të datës 12.12.2023, të Përmbartuesit Privat Eset Murati.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.352/23 i datës 12.12.2023, i Përmbartuesit Privat Eset Murati.
- III. Në rast se debitori parashton ankesë kundër këtij aktvendimi, Urdhërohet që në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas pranimit të aktvendimit, të paguaj garancinë në shumë prej 4,931.30 €.
- IV. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Profiti” N.T.SH., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.352/23 të datës 12.12.2023, me të cilin e ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.22-SHV01-001-8913 të datës 12.12.2022, me të cilin ka detyruar debitorin që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 4,931.360 €, me kamat ligjore 8% në vit, duke filluar nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, ashtu të bllokohen të gjitha llogaritë bankare pranë të gjitha bankave, po ashtu dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se fatura e cila është objekt i kësaj procedure përmbartimore nuk është e vulosur nga debitori, as nënshkrimi nuk është i ndonjë personi përgjegjës të debitorit, andaj e njëjta nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta anuloj.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar se baza për prapësim duhet të mbështetet në prova të duhura, ndërsa sa i përket pretendimit se fatura nuk është e vulosur dhe e nënshkruar nga ana e debitorit, e njëjta nuk qëndron sepse fatura është dorëzuar në origjinal dhe është e nënshkruar dhe vulosur nga ana e të njëjtit. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën Nr.22-SHV01-001-8913 të datës 12.12.2022, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, gjë e cila vërtetohet nga nënshkrimi si dhe vula e debitorit.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin që në rast të parashtrimit të ankesë kundër këtij aktvendimi, të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t’ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.64/24, datë 28.05.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.